



REPUBLIKA E KOSOVËS-RI  
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME  
MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS  
SEKTORI I ARKIVËS-SE

10 2062  
07 31 08 21  
Prishtinë

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore -  
Ministry of Foreign Affairs and the Diaspora

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	280/2021		
PËR/ZA/TO:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme – Zyra Kombëtare e Auditimit Hykmete Bajrami, Kryetare e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP)		
CC:	Anëtarët e KMFP-së Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – MPJD		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Donika Gërvalla-Schwarz, Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit		
Nr. i zyrës:	401	Lokacioni:	Rr. "Luan Haradinaj",
Br. kancelarije:		Kucni:	10000, Prishtinë
Room No.:		Extension:	
Data:		Datum:	20.08.2021
Date:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION			X
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			X
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE:			X



E nderuara znj. Spanca,  
e nderuara znj. Bajrami,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pranuar raportin përfundimtar të auditimit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2020.

Bazuar në nenin 23 pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe duke u mbështetur në rregulloren e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, po ju dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve për MPJD-në, të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Jam plotësisht e vendosur për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe e përkushtuar për vendosjen e rregullit dhe të disiplinës financiare si dhe për ngritjen e përgjegjësisë së kontrollit të brendshëm në kuadër të MPJD-së.

Pa dyshim, në këtë kohë është shumë i nevojshëm roli dhe ndihma juaj për ngritjen e përgjegjësisë së zyrtarëve publikë gjatë shpenzimit të parasë publike, andaj pres bashkëpunimin tuaj të plotë.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANUAR DOREZUAR:  
DATUM PRILJEN DOSTAVLJEN:  
DATE RECEIVED SUBMITTED: 01.09.2021

Njësi Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqëve Br. Stranica No. Pages
03	47	1706	07

Nr.	Çështja	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra apo të planifikuara për tu ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1	A1 – Mos regjistrim i plotë i shpenzimeve të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore në SIMFK	<p>MPJD kishte shpalosur në RVF avance të pambyllura për Ambasada dhe Konsullata në shumë 1,641,152€. Këto shpalosje (avance të pambyllura) kanë të bëjnë me shpenzimet që kanë bërë Misionet Diplomatike dhe Konsullore (MDK) të cilat nuk ishin regjistruar në SIMFK si shpenzime nga ana e ministrisë edhe pse ishin raportuar nga MDK-të. Mos regjistrimi i këtyre shpenzimeve ka ndikuar që vlera e shpenzimeve e prezantuar në nenin 13 - Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme dhe 14 - Raporti i ekzekutimit të buxhetit të RVF-së të jetë jo e plotë dhe e nënvlerësuar.</p> <p>Për më tepër, ekziston një mos barazim i avanseve në vlerë prej 53,848€, në mes Raportit Vjetor Financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës (1,695,000€) dhe RVF-ve të MPJD-së (1,641,152€). Për këtë mosbarazim ministria nuk ishte në gjendje të na ofroj sqarimet e nevojshme.</p>	<p>Ministrja duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet e raportuara nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore regjistrohen në SIMFK sapo të pranohen nga zyrtarët përgjegjës të MDK-ve dhe të njëjtat raportohen në fund të vitit në RVF si shpenzime totale të ministrisë.</p>	<p>Deri tani (në momentin e raportimit), nga buxheti i vitit aktual (2021), rreth 300,000.00 euro avance të pambyllura janë shpenzuar nga ambasadat dhe konsullatat për vitin e kaluar (2020). Implementimi i këtij rekomandimi nuk varet vetëm nga veprimet e MPJD-së, ngase nevojitet një masë buxhetore shtesë për t'i mbyllur këto avance, të bartura ndër vite.</p> <p>Prandaj, kërkesën për buxhet shtesë do ta paraqesim te Ministria e Financave, në mënyrë që të mbyllen obligimet e bartura nëpër vite. Po ashtu, në qarkoret buxhetore do të paraqiten kërkesat e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të rregullta vjetore të misioneve diplomatike, në mënyrë që këto shpenzime të mbuloohen me buxhetin e vitit fiskal.</p>	ZKF, ZKA	TM4_2022
2	B1 - Regjistri jo i plotë i pasurisë kapitale	<p>Vlera e pasurisë (2,680,701€) e prezantuar në nenin 19.3.1 Pasuritë kapitale me vlerë mbi 1,000€ në RVF nuk ishte e plotë dhe e saktë për shkak se: Në regjistrin e pasurisë në SIMFK nuk ishin regjistruar 10 vetura të cilat ishin blerë në vitin 2020 për nevoja të Ambasadave në vlerë 296,373€ si dhe mobiljet në vlerë 2,656€ të blera për Konsullatën e Përgjithshme në Strugë.</p>	<p>Ministrja duhet të siguroj që në rastin e transfereve të stafit në MDK të ketë një planifikim paraprak për plotësimin e pozitave që lirohen në mënyrë që mos të shkaktohen pengesa në operim si pasojë e mungesës së stafit.</p> <p>Rrjedhimisht, pozita e Zyrtarit të Pasurisë të</p>	<p>Pozita e zyrtarit të pasurisë do të plotësohet me staf, si dhe të gjitha pasuritë kapitale të paregjistruara do të regjistrohen në SIMFK.</p>	ZKA, ZKF, Zyrtari i pasurisë	TM4_2021

			plotësohet me staf të rregullt dhe të gjitha pasuritë e paregjistruara të regjistrohen në SIMFK.			
3	<i>A2 - Regjistrim i pasurisë në klasën jo adekuate dhe gabime në përlllogaritje të zhvlerësimit</i>	<p>Në kuadër të testimeve të kryera në fushën e pasurisë kapitale kemi identifikuar që tre llap-top në vlerë 3,042€ të blerë në vitin 2018 ishin regjistruar në kategorinë “Pajisje të IT-së” në SIMFK ku norma e përgjithshme e zhvlerësimit sipas metodës drejtvizore është 3 vite dhe jo në kategorinë “Kompjuterë” ku norma e përgjithshme e zhvlerësimit është 4 vite. Si rrjedhojë vlera neto e tyre në fund të vitit 2020 ishte e nënvlerësuar për 718€.</p> <p>Më tutje, pasuritë jo kapitale të MPJD-së nuk regjistrohen në sistemin E-pasuria por regjistrohen manualisht në një regjistër të brendshëm që OB e mban në Excel. Gjatë testimeve tona ne kemi identifikuar që 25 kompjuterë dhe 6 llap-top në vlerë 18,821€ ishin regjistruar në kategorinë e “Mobiljeve” ku norma e përgjithshme e zhvlerësimit sipas metodës drejtvizore është 6 vite dhe jo në kategorinë adekuate “Kompjuterë” ku norma e përgjithshme e zhvlerësimit është 4 vite. Për më tepër, pajisjet ishin blerë në muajin nëntor të vitit 2020 dhe zhvlerësimi ishte kalkuluar për tërë vitin 2020 (12 muaj), ndërsa është dashur të kalkulohej vetëm për një muaj duke përjashtuar muajin e blerjes së pasurive. Si rezultat i regjistrimit të pasurisë në kategorinë jo adekuate dhe gabimeve në përlllogaritje të zhvlerësimit, vlera neto e pasurisë ishte nënvlerësuar për 2,745€.</p> <p>Poashtu gabime në përlllogaritje të zhvlerësimit kishte edhe tek 19 artikuj me vlerë fillestare 6,372€ të blera në vitin 2020 në kategorinë “Mobilje” ku si rezultat i gabimeve në zhvlerësim, vlera neto e pasurisë ishte mbivlerësuar për 183 €.</p>	<p>Ministrja duhet të siguroj që të gjitha pasuritë të regjistrohen në klasat adekuate dhe të bëhet përlllogaritja e saktë e zhvlerësimit.</p> <p>Poashtu duhet të merren masa në funksionalizimin e sistemit E-pasuria për regjistrimin e pasurisë nën 1,000€ konform kërkesave ligjore.</p>	<p>Do të rritet niveli i kontrollit në këtë sistem, që të mos përsëriten raste të tilla edhe më tutje.</p> <p>Sa u përket pasurive kapitale, do të ndërmerren veprime të menjëhershme për korrigjimin e normës së zhvlerësimit sipas klasifikimit të përcaktuar me kërkesat ligjore.</p> <p>Sa u përket pasurive jokapitale, së pari do të caktohet zyrtari i pasurisë, i cili pastaj, në bashkëpunim me zyrtarin e pranimit (logjistikës), do t'i identifikojë dhe do t'i regjistrojë të gjitha pasuritë e paregjistruara në sistemin E-pasuria, sipas kërkesave të përcaktuara ligjore.</p>	Drejtori i DFSHP, ZKF, Zyrtari i pasurisë	<p>TM4_2021</p> <p>TM3_2022 <i>Ky proces kërkon më shumë kohë për shkak se nevojiten identifikimi dhe dokumentimi i pasurive ndër vite.</i></p>
4	<i>A3 – Dobësi në menaxhim të personelit</i>	<p>Pozita “Udhëheqës i Divizionit të Personelit” në MPJD ishte mbajtur me Ushtues detyre për një periudhë nëntë mujore duke filluar nga muaji tetor i vitit 2019. Më pas, zyrtares së njëjtë në</p>	<p>Ministrja duhet të ndërmerren masa konkrete për të zgjidhur problemin e pozitës së udhëheqësit të</p>	<p>Zv. Sekretarja e Përgjithshme më 12.8.2021 ka nxjerrë Vendimin nr. 160/2021 për caktimin e udhëheqësit të</p>	ZKA	E zbatuar

		korrik të vitit 2020 i është lëshuar një vendim përmes të cilit ishte caktuar si zëvendësim në pozitë në Divizionin e Personelit deri në përfundim të procesit të rregullt të rekrutimit. Mirëpo, nga muaji prill 2020 MPJD e kishte të punësuar me aktemërim të rregullt "Udhëheqësin e Divizionit për Burime Njerëzore" si rezultat i bashkimit me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS). Rrjedhimisht nga muaji prill i vitit 2020 për të njëjtën pozitë paguhen dy zyrtarë.	divizionit të personelit konform kërkesës ligjore, në mënyrë që të evitohet shpenzime të paarsyeshme për pozitë të cilat tashmë janë të mbuluara me staf të rregullt.	Divizionit të Burimeve Njerëzore për MPJD-në, sipas rekomandimit të ZKA-së.		
5	A4 - Tejkallim i limiteve bankare nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore	Ne kemi testuar disa MDK për muajin maj (Konsullata Shtutgart, Konsullata Mynhen) dhe për muajin dhjetor (Konsullata Shtutgart, Konsullata Mynhen, Dyseldorf, Ambasada e Kosovës në Bern dhe Konsullata në Gjeneve) dhe kemi vërejtur se limiti për mbajtjen e mjeteve financiare ishte tejkalluar mbi normën e përcaktuar me udhëzimin administrativ. Sipas Thesarit tejkallimet e limiteve nga MDK ishin: Konsullata Shtutgart limitin e lejuar e kishte 50,000€ ndërsa tejkallimi ishte 93,765€ (dhjetor) dhe 75,060€ (maj), Konsullata Mynhen limitin e lejuar e kishte 50,000€ ndërsa tejkallimi ishte 63,070€ (dhjetor) dhe 52,439€ (maj), Dyseldorf limitin e lejuar e kishte 50,000€ ndërsa tejkallimi ishte 235,984€, Ambasada e Kosovës në Bern limitin e lejuar e kishte 50,000€ ndërsa tejkallimi ishte 68,959€ dhe Konsullata në Gjeneve limitin e lejuar e kishte 50,000€ ndërsa tejkallimi ishte 67,426€).	Mbajtja e mjeteve mbi limitin e lejuar bankar përveç që është në kundërshtim me udhëzimin administrativ të MPJD-së mund të ndikon që të rriten shpenzimet nëpër MDK.	Në prill 2021 është aprovuar kërkesa drejtuar Thesarit për rritjen e limiteve financiare në llogari bankare për nëntëmbëdhjetë (19) MDK.  Në këtë proces do të rritet niveli i kontrollit, në mënyrë që limitet e aprovuara të respektohen.	ZKF, MDK	TM4_2021  Në vazhdimësi
6	A5 – Mos raportim lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare nga MDK-të	Kemi identifikuar se vetëm tetë (8) MDK kishin raportuar në Divizionin e Transportit/ Logjistikës në MPJ për shpenzimet mujore për të gjitha automjetet e Misionit ndërsa MDK tjera nuk kishin raportuar fare.	Ministrja duhet të siguroj që, nga MDK-të mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe raportet mujore të dërgohen në divizionin përkatës sipas kërkesave të rregullores në fuqi.	Të gjitha MDK-ve do t'u dërgohet një qarkore lidhur me obligimet ligjore për mbajtjen dhe raportimin e evidencave për shpenzimet mujore për të gjitha automjetet.	Drejtori i DFSHP, MDK	Shtator 2021
7	B2 - Vonesa në raportim të shpenzimeve	Edhe në vitin 2020 kemi vërejtur vonesa në procesin e raportimit nga ana Misioneve Diplomatike dhe Konsullore. Kjo dukuri ishte raportuar edhe vitet paraprake, dhe gjendja	Ministrja duhet të siguroj që raportimi i shpenzimeve nga MDK-të të bëhet në kohë në	Do të rritet niveli i kontrollit në këtë proces, në mënyrë që raportimi nga MDK-të të bëhet brenda afatit prej 15	ZKF, MDK	Shtator 2021 - TM4_2021

	<i>nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore</i>	pothuajse është e njëjtë. Vonesat e identifikuarra ishin mbi afatin kohor prej 15 ditësh.	mënyrë që MPJD të bëjë regjistrimin e shpenzimeve në SIMFK.	ditësh nga përfundimi i muajit. Për të forcuar kontrollin edhe më tutje, të gjitha MDK-ve do t'u dërgohet një qarkore për obligimet ligjore që raportimi të bëhet sipas afateve të përcaktuara.		
8	<i>CI – Mos mbyllje e avanceve</i>	MPJD në nenin 20 të PFV-ve kishte prezantuar vlerën financiare 42,207€ për avancet e pa arsyetuara. Këto avance ishin për udhëtime zyrtare dhe kanë të bëjnë me Ish Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (21,488€) dhe MPJ (20,719€). Ne kemi identifikuar se avancet e tilla nuk janë mbyllur gjatë vitit 2020 edhe pse për disa avance ishin ofruar dëshmi (fatura, kthim i mjeteve) që dëshmojnë se ato janë të gatshme për mbyllje.	Ministrja duhet të ndërmerr masa konkrete në mënyrë që të gjitha avanset të mbyllen duke i respektuar rregulloret në fuqi.	Të gjitha avancet, të cilat janë të arsyetuara nga zyrtarët përkatës dhe të gatshme për shpenzim, do të ekzekutohen në SIMFK brenda shtatorit. Për avancet, të cilat nuk janë arsyetuar ende, do të merren veprimet e nevojshme ligjore që ato të mbyllen dhe të ekzekutohen.	ZKA, ZKF, Certifikuesi	Shtator 2021
9	<i>A6 - Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë</i>	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës me datën 27.08.2018, kishte lidhur kontratën publike kornizë "Shërbime Postare Diplomatike". Vlera indikative e kontratës ishte 400,000€. Ne kemi identifikuar se MPJD gjatë periudhës 2018-2020 kishte bërë pagesa për shërbimet në vlerë 568,412€, duke bërë tejkalimin e vlerës së kontratës për 48,412 € mbi normën e lejuar 30%. Vlera totale indikative e kontratës ishte 400,000€, plus 30% (120,000€), gjithsej shuma e lejuar për pagesë ishte 520,000€.	Ministrja duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.	Menaxherëve të kontratave u kemi dërguar emailin rikujtues për obligimet ligjore që dalin nga LPP për menaxhimin dhe administrimin e kontratave, duke përfshirë vlerën apo sasinë e kontratës. Gjithashtu, menaxheri i prokurimit është takuar me menaxherët e kontratave, të cilëve ua ka rikujtuar obligimet dhe ka kërkuar që të rritet niveli i kontrollit në këtë proces.	Udhëheqësi i prokurimit (ZP), Menaxherët e Kontratave	16 gusht 2021. Në vazhdimësi
10	<i>A7 - Shpenzime të udhëtimit për persona që nuk janë pjesë e MPJD-së</i>	Nga kategoria mallra dhe shërbime, MPJD me aprovim të Sekretarit të Përgjithshëm kishte bërë pagesa për bileta të udhëtimit për persona të cilët nuk janë staf i sajë. Pagesat ishin bërë për një person në destinacionin Abudabi-Cyrih në vlerë 4,715€ dhe për tre persona në destinacionin Cyrih-Prishtinë në vlerë totale prej 897€. Për më shumë palët përfituese ishin zotuar (deklaratë me shkrim) që pas arritjes në Kosovë do t'i kompensojnë mjetet financiare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ne kemi kërkuar sqarime nëse mjetet për pagesën e biletave janë kthyer në MPJD por sipas zyrtarëve	Ministrja duhet të ndërmerr masa që në rastet e pagesave për persona tjerë që nuk janë pjesë e MPJD-së, të sigurohet se këto mjete do të kthehen në llogarinë e ministrisë sipas zotimit të përfituesit, në periudhën e caktuar nga ministria.	Në fillim, nga palët përfituese do të kërkohet të bëhet kthimi i mjeteve në pajtim me zotimet e tyre (deklaratë me shkrim), duke përcaktuar një afat të përbashkët kohor me palët. Në rast të moskthimit të mjeteve, do të merren veprimet e nevojshme ligjore për kthimin e tyre.	ZKA, ZKF, Zyra Ligjore	Tetor 2021

		të ministrisë mjetet nuk ishin kthyer derisa ne ishim në auditim. Sipas korrespondencave kjo kishte ndodhur si pasojë e mbylljes totale nga Covid 19 dhe qytetarëve ju ka humbur e drejta e udhëtimit me biletat që i kanë poseduar.				
11	A8 - Klasifikim i gabuar i shpenzimeve	MPJD ishte furnizuar me pajisje të teknologjisë informative, 25 kompjuterë dhe 6 llap-top në vlerë 18,821€. Paguesa për këto furnizime ishte bërë nga kategoria e investimeve kapitale përderisa çmimi për njësi për artikujt e blerë kishte vlerë nën 1,000€ dhe si të tillë këta artikuj i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.	Ministrja duhet të siguroj që pagesat për shpenzime të bëhen nga kategoria adekuate ekonomike dhe rrjedhimisht gjendja e shpenzimeve të raportohet drejtë në PVF.	Gjatë planifikimeve buxhetore do të bëhet një vlerësim i kërkesave nga njësitë, me ç'rast do të përcaktohet kategoria adekuate e buxhetit, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten raste të tilla.	ZKF, Drejtori i DFSHP, Udhëheqësi i prokurimit (ZP).	TM4_2021
12	A9 - Mos formimi i Komisionit për vlerësim të markave llojit dhe specifikave të automjeteve që do të blihen në MDK	Në procedurën e prokurimit "Blerja e veturave për nevoja të Ambasadave" në vlerë 259,123€, MPJD nuk kishte formuar komisionin i cili bën vlerësimin e markave më të përshtatshme, llojin dhe specifikat e automjeteve që duhet të blihen në misionet diplomatike/konsullore. Megjithatë, markat e veturave dhe specifikat lidhur me këtë procedurë ishin negociuar nga Komisioni negociues i formuar në MDK.	Ministrja duhet të siguroj që në rastin e blerjes së automjeteve për Misione Diplomatike Konsullore, vlerësimi i markave, llojeve dhe specifikave të automjeteve të bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik.	Në momentin e pranimit të draftraportit të auditimit, menjëherë i kemi marrë masat për rritjen e nivelit të kontrollit. Për çdo procedurë do të zbatohen kërkesat ligjore të LPP-së, përkatësisht do të formohet komisioni për vlerësimin e markave më të përshtatshme, llojin dhe specifikat e automjeteve që duhet të blihen në MDK. Në vitin 2021 nuk kemi pasur raste të tilla, prandaj, si rrjedhojë, ky rekomandim është adresuar.	ZKA, MDK, Udhëheqësi i prokurimit (ZP).	E zbatuar

## Besiana Havolli

---

**From:** Besiana Havolli  
**Sent:** Friday, August 20, 2021 5:57 PM  
**To:** Hykmete Bajrami; 'vlora.spanca@oagks.org'  
**Cc:** Ariana Zherka Hoxha; Hamdi Berbatovci  
**Subject:** Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve -Të auditorit të Përgjithshëm  
**Attachments:** Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA për vitin 2020 - MPJD.pdf

E nderuara znj. Spanca,  
E nderuara znj. Bajrami,

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, neni 23, pika 5, në mbështetje të rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit, po ju dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit për vitin 2020 nga Zyra Kombëtare e Auditimit për MPJD-në.

Të njëjtin dokument do të përcjellim në formë fizikë.

Me respekt,

Kind regards,

**Besiana Havolli**

Personal Assistant of the Minister

Mob.: +383 44 774 903

Tel.: +383 (0) 38 200 77005

Email: [besiana.havolli@rks-gov.net](mailto:besiana.havolli@rks-gov.net)

Adresa: Rr. Luan Haradinaj,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



**Republic of Kosovo**  
*The Government*

**Ministry of Foreign Affairs and Diaspora**